REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA MALIQ

Nr. 6677 Prot

Maliq, më 16.12.25

Lënda: **Njoftim për inventarizim dhe nxjerrje jashtë përdorimit të aktiveve**

Drejtuar: **Këshillit Bashkiak**

Të nderuar këshilltarë !

Në mbështetje të ligjit nr.139/2015 datë 17.12.2015, "*Për vetëqeverisjen vendore*", neni 64 "Kompetencat dhe detyrat e Kryetarit të Bashkisë"pika c ; ligjit 9936 datë 26.06.2008 *"Për menaxhimin e sistemit buxhetor në Republikën e Shqiperisë"* neni 32 *"Përgatitja dhe miratimi i buxheteve vendore*", ligjit 68/2017 *"Për financat e qeverisjes vendore* '' po ju njoftojmë për inventarizimin dhe nxjerrjen jashtë përdorimit''

Duke ju uruar punë të mbarë!

Me respekt

Konceptoi: F. Dervollari

Miratoi: A. Muka

KRYETARI I BASHKISË

Gëzim TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ

REPUBLIKA E SHQIPËRISË

BASHKIA MALIQ

Raport Përmbledhës,Inventarë 2024

Komisioni i inventarizimit dhe vlerësimit, i ngritur me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Maliq Nr.470 datë 30.09.2024, i ndryshuar me Urdhër të Kryetarit të Bashkisë Maliq Nr.471/01,datë 16.10.2024,i përbërë nga 4 anëtarë nga Bashkia Maliq dhe nga nëpunësit e financës të Njësive Administrative (anëtarë në njësitë përkatëse) , ka vërtetuar saktësinë dhe cilësinë e gjendjes fizike të aktiveve të Bashkisë Maliq për vitin 2024, bazuar në Ligjin Nr. 10296, datë 08.07.2010 "Për menaxhimin financiar dhe kontrollin"; Udhëzimin Nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik" dhe Udhëzimin e Ministrit të Financave nr. 20, datë 17.11.2014 për disa shtesa dhe ndryshime në udhëzimin nr. 30, datë 27.12.2011 "Për menaxhimin e aktiveve në njësitë e sektorit publik".

Komisioni ka kryer inventarin fizik dhe kontrollin për ekzistencën dhe vlerësimin e aktiveve afatgjata materiale dhe jomateriale, aktiveve afatshkurtra, të detyrimeve dhe të drejtave, nëpërmjet inventarizimit të këtyre elementëve dhe hartimin e dokumentacionit mbështetës për secilën drejtori apo sektor të bashkisë. Inventarizimi është kryer sipas rastit me numërim apo verifikim të objekteve.

Komisioni i inventarizimit ka përmbushur përgjegjësitë e veta për:

a. Verifikimin fizik dhe cilësor të gjendjes së aktiveve në ngarkim/përdorim të personelit të bashkisë dhe njësive administrative për pasqyrimin e të dhënave të inventarizimit në procesverbalin përkatës, i cili është ruajtur gjatë gjithë periudhës së inventarizimit

b. Krahasimin e gjendjes konkrete të aktiveve me të dhënat përkatëse të dokumenteve të inventarizimit të hartuara për vitin 2024, të cilat mbahen nga punonjësit me përgjegjësi materiale dhe të cilat janë të përputhura me sektorin e financës duke marrë dhe mendimin e specialistëve përkatës dhe në rastet e diferencave hartimin e procesverbaleve përkatëse

c. Hartimin e raporteve të veçanta për çdo zyrë të bashkisë lidhur me inventarizimin fizik të aktiveve, për kushtet e ruajtjes së tyre, gjendjen fizike dhe për vërejtjet lidhur me karakterin e diferencave e dëmtimeve të konstatuara, për shkaqet e tyre dhe personat përgjegjës dhe, së bashku me gjithë dokumentacionin e inventarizimit i ka dorëzuar për veprime të mëtejshme tek Nëpunësi Autorizues.

Komisioni i inventarizimit, ka konstatuar se disa materiale të vjetra dhe të papërdorshme, kanë plotësuar afatin e përdorimit dhe janë shumë të konsumuara apo janë dëmtuar nga ndodhi të rastit gjatë përdorimit dhe riparimi i tyre është i pamundur ose i kushtueshëm në krahasim me vlerën e mallit. Për këto arsye, komisioni vendosi që këto materiale, të cilat i përkasin si inventarit të imët ashtu dhe inventarit ekonomik, të nxirren jashtë përdorimit.

Vlefta e të dhënave kontabël përputhet me vleftën e të dhënave të inventarizimit.

Nxjerrja e aktiveve jashtë përdorimit është kryer kur sipas rastit:

a. Është plotësuar koha e shftyrëzimit në bazë të normave të amortizimit apo afatit të skadencës dhe nuk mund të riparohen;
b. Riparimi është i pamundur si pasojë e konsumit dhe nuk mund të përshtaten për përdorim tjetër;
c. Janë thyer apo dëmtuar në shkallë të tillë që është e pamundur të kthehen në gjendje pune nëpërmjet riparimit;
d. Vlera e riparimit ose e përshtatjes për t'i kthyer në gjendje pune është e barabartë ose më e madhe se vlera e tregut për blerjen e një aktivi të ngjashëm;
e. Ka kaluar afati i vlefshmërisë së tyre dhe nuk mund të përdoren si të zhvleftësuara ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër;
f. Kanë humbur cilësitë e tyre të caktuara në standartet shtetërore ose në kushtet teknike dhe nuk mund të përdoren si të zhveftësuara ose për qëllim tjetër në formën që janë ose në formë tjetër, megjithëse nuk ka kaluar afati i vlefshmërisë;
g. Janë dëmtuar e janë bërë të papërdorshme, si pasojë e ndodhive të rastit;
h. Si pasojë e ndryshimit të kërkesave teknike, kushteve të punës, misionit të njësisë, objektivave afatmesme ose afatgjatë nuk janë gjetur mundësitë e përdorimit për qëllimin e caktuar ose për qëllime të tjera, ashtu siç janë ose edhe me përshtatje.

Bazuar në procesverbalin e nxjerrjes jashtë përdorimit për inventarin ekonomik, rezulton se shumica e materialeve janë nxjerrë jashtë përdorimit për shkak të plotësimit të afatit dhe pjesa tjetër për shkak të dëmtimit në punë jo për faj të punonjësit përgjegjës.

Materialet të cilat janë të riciklueshme,do të hiqen nga rregistri i aktiveve në përdorim,do të bëhen hyrje në magazinë dhe do të shiten në ankand ndërmarjeve që i grumbullojnë.

Vlefta e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit për inventarin ekonomik sipas të dhënave kontabël paraqitet si mëposhtë:

Nr.	Emërtimi i inventarit	Vlera
1	Bashkia Maliq	2,917,209
2	Nj. Adm. Pojan	492,161
3	Nj. Adm. Libonik	403,697
4	Nj. Adm. Pirg	397,451
5	Nj. Adm. Vreshtas	1,238,123
6	Nj. Adm. Gorë	443,760
7	Nj. Adm. Moglicë	363,310
	TOTALI	**6,255,711**

Vlefta e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit për inventarin e imët sipas të dhënave kontabël paraqitet si mëposhtë:

Llogaria 327,312;

Nr.	Emërtimi i inventarit	Vlefta
1	Bashkia Maliq	1,178,373
2	Nj.Adm.Pojan	683,750
3	Nj. Adm. Libonik	168,072
4	Nj. Adm. Pirg	74,876
5	Nj. Adm. Vreshtas	73,820
6	Nj. Adm. Gorë	28,355
7	Nj. Adm. Moglicë	3785.2
	TOTALI	**2,211,031**

Vlefta e materialeve të nxjerra jashtë përdorimit për vitin 2024 në total është **8,466,742** lekë . I gjithë dokumentacioni është firmosur nga personi përgjegjës dhe komisioni i inventarizimit. Dokumentacioni është hartuar në tre kopje, prej të cilave një kopje i është dorëzuar Nëpunësit Autorizues, një kopje personave përgjegjës dhe një kopje është mbajtur prej Komisionit të Inventarizimit dhe Vlerësimit.

KOMISIONI I INVENTARIZIMIT DHE VLERËSIMIT

1- **Almira** **Muka**
2- **Fjoralda** **Demollari**
3- **Nertila** **Likaj**
4- **Devis** **Mollaymeri**

MIRATOHET
KRYETARI I BASHKISË
GËZIM TOPÇIU

REPUBLIKA E SHQIPËRISË - BASHKIA MALIQ